



KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMIT

01 NR. 351-34244/KG
DATE 13.08.2019

Bazuar ne LPP 04/L-042 I ndryshuar dhe amandaetuar ne Ligjin nr.05/L-068 dhe 05/L-092 , neni 108/A , zyra e prokurimit ,me date 13.08.2019 ,ne përgjigje te Kërkesës për Rishqyrtim te O.E . merr :

VENDIM

Hedhet Poshtë Kërkesa për Rishqyrtim e O.E “ I & B GROUP nga Prishtina e postuar ne e-prokurim me date 10.08.2019 Për Procedurën e Prokurimit Nr. 634-19-4425-521 Asfaltimi i rrugëve Lot 1- Radullovc –Pataqan dhe Lot 2- Dollc

Arsyeshmeri

1. O.E , pretendon se i është bere e padrejte pasi qe ai ne te dy lotët ishte me çmimin me te lire dhe Siç pretendon është dashur te beje përzgjedhje ai e jo A.K.
2. A.K., konstaton se nuk qëndron ky pretendim, meqenëse ne Njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit , kriter për dhënje te kontratës ishte .I përgjegjshëm çmimi me i ulet , Dhe Vendimi i A.K. qe ne ketë Projekt një O.E do te mund te shpërblehet vetëm me një kontratë, Andaj gjate kalkulimit te kombinimit Lot 1- Oferta e dyte me radhe dhe Lot 2 Oferta e pare me radhe kane dhëne Vlerën me te ulet për A.K. Lot 1 – Burimi vlere 54.444.95 €, Lot 2- I&B-GROUP, vlere 29.397.58€ totali = 83.842.53€.
3. Kombinimi tjetër Lot 1- Oferta me e ulet (pretenduesi) I & B – group vlere 54.371.33 € dhe Lot 2 –Burimi vlere 35.430.68 € =69.802.01 A.K do i kushtonte me vlerën me te larte per 5.959.48 € Andaj Ky ishte edhe Vlerësim i drejtë i A.K.

Baza juridike

Kunder këtij vendimi O.E , bazuar ne Nenin 109 te LPP ka te drejte te paraqes ankes pranë OSHP .

Abaz Foniqi





KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMIT

01 NR. 351-39251/19
DATE 13.08.2019

Bazuar ne LPP 04/L-042 I ndryshuar dhe amandaetuar ne Ligjin nr.05/L-068 dhe 05/L-092 , neni 108/A , zyra e prokurimit ,me date 13.08.2019 ,Pas Kërkesës për Rishqyrtim te O.E I & B –Group nga Prishtina . merr :

VENDIM

PER SUSPENDI TE PERKOHESHEM TE AKTIVITETIT TE PROKURIMIT

Nr. 634-19-4425-521 Asfaltimi i rrugëve Lot 1- Radullovc –Pataqan dhe Lot 2- Dolle.

Arsyeshmeri

Suspendimi do te vlej deri sa te përfundojnë procedurat e Ankimit te O.E “ I & B GROUP nga Prishtina

Baza juridike

Kunder këtij vendimi O.E , bazuar ne Nenin 109 te LPP ka te drejte te paraqes ankes pranë OSHP .

Abaz Foniqi

